Vj. Ad. Libonik.
- ST/Rep
dt 22.07.2026

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 4516 Prot.
Date 22.7.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Nr. 21012-00635-41-2026 (1527) Akti
Datë 10.06.2026

Korce ne date 17.07.2026

"NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE "

"Per njoftimin e padise, akteve dhe kerkeses per leshimin e "Deklarates se Mbrojtjes"

Drejtuar per afishim: Ne kendin e njoftimeve prane Bashkise Maliq.

Drejtuar: Pales se paditur Kristofor Bregu, banues ne adresen: Libonik, Rruga "Tregut", Nd.1, H.6, Ap.7, Bashkia Maliq.

Prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korçe eshte duke u gjykuar çeshtja civile qe i'u perket paleve:

PADITËSE: Klara Ahmetlli (Bregu)

I PADITUR: Kristofor Bregu

OBJEKTI: Leshimin e autorizimit te perhershem te udhetimit jashte Republikes se Shqiperise me shoqerimin e nenes Klara Ahmetlli pa autorizimin e babait, te femijeve te mitur 1.Joana Bregu e datelindjes 11.01.2011 dhe 2.Adriatik Bregu i datelindjes 25.08.2014.

Gjykata pasi ezauroi etapat procedurale per njoftimin Tuaj sipas neneve 129-133 te K.Pr.Civile, si me siper, vendosi te procedoje me njoftimin nepermjet shpalljes publike, bazuar ne nenet 133/a dhe 133/b, te K.Pr.Civile, duke u afishur nje kopje e shpalljes prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korçe, si gjykata ku gjykohet mosmarreveshja, nje kopje prane Bashkise Maliq ku ndodhet vendbanimi Juaj, nje kopje ne deren e baneses Tuaj dhe ne faqen zyrtare te gjykates.

Nepermjet ketij njoftimi Ju bejme me dije se jeni thirrur ne cilesine e te padituri ne kete proces gjyqesor dhe prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korçe, zyres se Gjyqtarit Klajdi Tërova mund te gjeni nje kopje te kerkesepadise, akteve shoqeruese dhe kerkeses per leshimin e "Deklarates se mbrojtjes".

Deklarata e mbrojtjes hartohet ne gjuhen shqipe dhe duhet te permbaje:

g) emrin, atesine, mbiemrin, vendbanimin ose vendqendrimin Tuaj dhe te personit/ave qe i'u perfaqeson/jne, nese keni te tille;

h) tregimin konkret te fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave te tjera, si dhe prapesimet dhe argumentet per kundershtimin e padise, nese keni

i) Perveç ketyre kerkesave, duhet te deklaroni qarte ne/ose bashkengjitur deklarates se mbrojtjes:

-Te dhenat e kontaktit Tuaj elektronik, ose te perfaqesuesit/ve Tuaj, nese keni, te cilat gjykata mund t'i perdore per t'iu njoftuar. Ne vijim te procesit keni detyrimin te informoni gjykaten per çdo ndryshim te adreses dhe te te dhenave te kontaktit elektronik Tuajat, apo te perfaqesuesi/vet. Shkelja e ketij detyrimi i ben te papranueshme pretendimet per pavlefshmerine e njoftimit;

-listen e personave qe kerkoni te thirren ne gjykim me cilesine e deshmitarit (nese kerkoni thirrjen e deshmitareve), duke specifikuar sakte emrat e tyre, atesine, mbiemrin dhe adresen e tyre te plote, si dhe faktet qe kerkohet te provohen me to;
-provat qe kerkohen te merren tek te tretet ose te paditesi, duke percaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave (nese ka te tilla);
-llojin e ekspertimit qe kerkohet te kryhet gjate gjykimit (nese kerkoni kryerjen e ndonje ekspertimi);
-emrin, atesine, mbiemrin, ose emertimin e personit juridik dhe adresen e plote te personave te trete qe kerkon te thirren ne gjykim me kete cilesi (nese kerkoni thirrjen e ndonje personi te trete);
-kunderpadine, kur kerkohet prej Jush ushtrimi i kesaj te drejte, sipas nenit 160 te ketij Kodi

Deklaraten e mbrojtjes mund t'a paraqisni me afat maksimal brenda 30 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e perfundimit e afati 20 (njezet) ditor te afishimit te shpalljes prej se ciles keni marre dijeni, ne te kundert e humbisni kete te drejte.

Kjo shpallje do te qendroje e afishuar ne vendet e mesiperme minimalisht 20 (njezet) dite nga dita e neserme e afishimit.

GJYQTAR
KLAJDI TËROVA

Shpallja u afishua sot në datë_____
Bashkia Maliq _____
Punonjesi_____